



Qendra për Progres Rinor
Kukës

Raport Monitorimi
Për funksionimin e Këshillave Vendorë Rinorë
në Qarkun e Kukësit.

Prill 2024

PASQYRA E PROGRAMIT

- Përmbledhja ekzekutive
- Funksimi i Këshillave Rinorë Qarku Kukës

II. Qëllimi i Raportit

III. Metodologjia

IV. Analizimi i të dhënave të mbledhura nga pyetësorët

- Bashkia Has
- Bashkia Tropojë
- Bashkia Kukës

V. Kujt i drejtohet ky studim?

VI. Korniza Ligjore e Këshillave Vendor Rinorë

VII. Funksimi i Këshillave Vendorë Rinorë

VIII. Përfundime dhe Rekomandime

IX. Aneks

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport vjen në vijimësi të nismës së Qendrës për Progres Rinor Kukës për të monitoruar punën e KVR-ve në tre Bashkitë e qarkut Kukës: Tropojë, Kukës dhe Has. Nevoja për një raport monitorues u pa si e tillë përgjatë punës së kësaj qendre me të rinj. Në kushtet e krijimit të këtyre këshillave rishtazi, monitorimi u krye duke mbledhur të dhëna primare nga vetë anëtarët aktualë të KVR-ve të këtyre tre bashkive përmes një pyetësoi dhe takimeve të drejtpërdrejta me ta, krahas dhe verifikimit të informacionit që anëtarët e KVR-ve deklarorin nga një ekspert i pavarur.

Burimet bazë të informacionit të reflektuar në këtë Raport Studimor rezultuan të jenë 3 takime me përfaqësues të KVR-ve dhe pyetësoi i plotësuar në mënyrë të anonimizuar. Ndonëse ligjvënësi ka përcaktuar shprehimisht momentin e ngritjes së KVR-ve, ende pas 5 vitesh zbatueshmërie të ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”, vërehet se Bashkitë objekt monitorimi nuk kanë garantuar në mënyrë të unifikuar aksesueshmërinë e publikut në informacionin mbi përbërjen e funksionin e KVR-ve. Më konkretisht, në asnjë prej ndërfaqeve zyrtare institucionale (website) të Bashkive Has¹, Kukës² dhe Tropojë³ nuk rezulton të jetë pasqyruar i strukturuar informacioni në një seksion të dedikuar për KVR-të. Si një rast analog pozitiv do të shërbente praktika e ndjekur nga Bashkitë Peqin⁴ dhe Kamëz⁵. Qartësisht diferencuese është qasja që ka mbajtur Bashkia Tropojë, e cila ka postuar në faqen e saj zyrtare disa informacione mbi aktivitetin e KVR-së⁶, e që vënë në dukje disa sesione trajnuese me realizuar në sezonin veror 2023.

Ligji nr. 75/2019 “Për Rininë” solli për herë të parë një trajtim të përgjithshëm për çështjet e rinisë në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë. Megjithatë, siç trajtohet dhe nga ky raport, ligji ka patur mangësi në implementimin dhe efektivitetin e tij. Si rrjedhojë, mund të themi se një

¹ <https://www.bashkiahas.gov.al/?s=kvr>

² <https://kukesi.gov.al/>

³ <https://tropoje.gov.al/?s=kvr>

⁴ <https://peqini.gov.al/keshilli-vendor-rinor/>

⁵ <https://kamza.instant.al/keshilli-rinor-kamez/>

⁶ <https://tropoje.gov.al/?s=kvr> ; <https://tropoje.gov.al/trajnim-3-ditor-me-perfaqesues-te-kvr-te-bashkise-tropoje/> ; <https://tropoje.gov.al/kendi-i-be/> ; <https://tropoje.gov.al/aktiviteti-peer-to-peer-me-te-rinjte-e-bashkise-tropoje/> ; <https://tropoje.gov.al/https-tropoje-gov-al-kendi-i-be/>

ndryshim i kornizës ligjore përsa i përket çështjeve rinore është i domosdoshëm në mënyrë që të jetë në koherencë me nevojat e rinisë si dhe të subjekteve të interesuara në këtë fushë.

Gjatë përpunimit të të dhënave u vu re se profilizimi moshor dhe gjinor i anëtarëve të KVR-ve në këto tre bashki të qarkut Kukës reflektonte një shtrirje të gjerë moshore (17-36 vjeç) dhe barazi gjinore në rang qarku (7 femra dhe 6 meshkuj). Po ashtu, u vu re se çdo qark (dhe për rrjedhojë çdo KVR) kishte krijuar perceptime të ndryshme të anëtarët e atij KVR-je.

Në KVR Kukës, shumica e anëtarëve shpreheshin të pakënaqur me mënyrën se si kishte funksionuar KVR Kukës dhe të gjithë anëtarët unanimitisht ishin pro ndryshimeve ligjore për të përmirësuar funksionimin e KVR-së.

Në KVR Has, anëtarët e KVR-së ishin të ndarë në ‘dy kampe’: gjysma shpreheshin të kënaqur me mënyrën se si kishte funksionuar KVR der në momentin aktual dhe e shihnin si të panevojshëm ndërhyrjen në ligj. Gjysma tjetër, shprehej e pakënaqur nga mënyra e operimit të KVR-së dhe shpreheshin ‘pro’ ndryshimeve ligjore.

Në KVR Tropojë, anëtarët shpreheshin në shumicë të kënaqur me funksionimin e KVR-së dhe asnjë prej tyre nuk shihte nevojën për ndërhyrjen ligjore.

Nga sa evidentohet dhe më sipër, duket se ekziston një raport i drejtë mes kënaqshmërisë së punës së KVR-së të anëtarët dhe mendimit të tyre mbi nevojën për të ndërhyrë në ligj. Një tjetër raport i drejtë i nivelit të kënaqshmërisë ishte ai me financimin. Në Bashkinë Tropojë, ky financim, sipas perceptimit të anëtarëve⁷, vinte nga buxheti vjetor bashkiak, ndërsa në Has, ata që shpreheshin të kënaqur evidentonin faktin që bashkia, sipas perceptimit të tyre, kishte mundur të fonde me anë të një projekti që ajo vetë kishte fituar. Ndërkohë, ata që shprehnin pakënaqësi me mënyrën se si kishte funksionuar KVR evidentonin mungesën e financimit.

Nisur nga raportet e drejtpërdrejta midis financimit dhe nivelit të kënaqshmërisë së punës së KVR, propozohet që të ketë disa ndryshime ligjore për të vendosur si detyrim ligjor financimin që bëhet me anë të buxhetit vjetor bashkiak. Ndryshime të tjera ligjore propozohet të jenë ndarja e postit të postin e kryetarit të KVR-së, nga posti i Kryetarit të Bashkisë, përcaktimi i një shumë shpërblimi monetar për anëtarin e KVR-së dhe lehtësi të tjera për kryerjen e detyrës së tyre, pajisja me një mjet identifikimi (tip kartë) të anëtarëve të KVR-së, përcaktimi në ligj të kompetencave të KVR si

⁷ Ndonëse anëtarët e KVR Tropojë shpreheshin se Bashkia financonte me anë të buxhetit vjetor të saj, aktivitetin e KVR-së, eksperti i pavarur i angazhuar për hartimin e këtij raporti, pas shqyrtimit të buxheteve të të treja bashkive, konstatoi se në të treja financimi i KVR-ve nuk ishte parashikuar në buxhetin vjetor.

organ konsultativ dhe përforcimin e pozitës së KVR në procesin vendimmarrës lokal në lidhje me politikat rinore, konsultimin me një sërë organizatash rinore për ndërhyrjet në ligj, parashikimin e mekanizmave për monitorimin e KVR-ve, si dhe përcaktimin në ligj të mundësisë së KVR-së për të mbështetur projekte dhe iniciativa lokale në lidhje me përmirësimin e jetës së rinisë lokale.

Raport Monitorimi
Funksionimi i Këshillave Vendorë Rinorë
Qarku Kukës

I. Hyrje

Pjesëmarrja aktive e të rinjve në vendimmarrjen në nivel lokal është thelbësore për një shoqëri më demokratike, gjithëpërfshirëse dhe të begatë. Të rinjtë kanë të drejtë të përfshihen në demokraci si pjesë e strukturave dhe proceseve që ndjek shoqëria jonë. Ata kanë të drejtë që zëri i tyre të dëgjohet dhe të ndikojnë në marrjen e vendimeve për çështje që i prekin vetë ata. Megjithatë, kjo kërkon që të rinjtë të njihen jo si një problem për t'u trajtuar por si aktorë në shoqëri, me të drejta dhe përgjegjësi. Në këtë kuadër, autoritetet duhet t'i angazhojnë në mënyrë të barabartë të rinjtë, duke shmangur marrëdhëniet hierarkike që vendosin rininë në një pozicion inferior.

Këshillat Vendor Rinor janë përcaktuar me ligj që në vitin 2019 me ligjin Nr. 75/2019 “Për Rininë”, e më tej është plotësuar kuadri ligjor për krijimin e tyre në vitin 2020 me anë të VKM-së Nr. 969, Datë 02.12.2020 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar të rinisë, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij”. Duke patur parasysh ndihmën që japin këto struktura rinore në funksionimin e demokracisë vendore, është me interes publik dhe monitorimi i funksionimit të tyre, pasi mosfunksionimi i tyre pengon përfshirjen e të rinjëve në vendimmarrje dhe kjo ndikon në qeverisjen e mirë. Ndërhyrja strategjike përmes monitorimit dhe vlerësimit, rezulton me hartimin e njëraporti, pas kryerjes së pyetsorëve dhe takime me KVR-të.

II. Qëllimi i Raportit

Mosfunksionimi i KVR-ve pengon përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje, duke ndikuar për rrjedhojë në qeverisjen e mirë ose mungesën e saj. Ky raport vjen në funksion të monitorimit, vlerësimit të funksionimit apo mos-funksionimit të KVR-ve në tre bashki: Kukës, Has, Tropojë. Synimi i tij është të sjellim një raport për funksionim e KVR-ve në këto tre bashki, me qëllim, nëse shihet e nevojshme, për të rishikuar ligjin për funksionim e KVR-ve.

III. Metodologjia

Trajtimi i çështjeve të lidhura me funksionimin e Këshillave Vendorë të Rinisë në një qark të caktuar kërkon domosdoshmërisht integrimin e të dhënave parësore si rrjedhojë e nevojës direkte për të patur një kampion informacioni nga individët e rinj të Qarkut Kukës.

Për të kryer një monitorim të plotë të funksionimit të KVR-ve në tre bashkitë e sipër-përmendura, raporti implementoi tre mënyra të marrjes së informacionit. Së pari, u hartua një pyetësor, i përbërë nga dy pjesë, i cili u shpërnda tek të gjithë anëtarët e KVR-ve. Dy pjesët e raportit ishin si fillim të dhëna personale me interes për studimin (mosha dhe gjinia) dhe si pjesë e dytë, 9 pyetje kyç mbi gjendjen e funksionimit aktual të KVR-së së bashkive përkatëse. Pyetësori u plotësua prej 13 anëtarëve të KVR-ve në këto bashki. Më tej, si metoda e dytë e marrjes së informacionit, u zhvilluan dhe 3 takime me anëtarët e KVR-ve (të ndarë sipas bashkive respektive), nga skuadra e Qendrës për Progres Rinor Kukës. Për të verifikuar vertetësinë e informacionit të deklaruar nga anëtarët e KVR-ve, u angazhua një ekspert i pavarur. Më tej në bazë të të dhënave të evidentuara nga këto mjete u hartua dhe ky raport monitorimi.

IV. Analizimi i të Dhënave të Mbledhura nga Pyetësorët

Pyetësorët e hartuar për këtë nismë, iu vunë në dispozicion anëtarëve të KVR-ve të tre bashkive: Hasit, Tropojës dhe Kukësit. Norma e përgjigjeve ishte shumë e lartë dhe thuajse e plotë (nga 16 anëtarë KVR-sh në total për të treja bashkitë bashkë, plot 13 iu përgjigjën pyetësorit). Përgjigjet që dhanë anëtarët sipas Bashkive hedhin shumë dritë mbi mënyrën se si funksionojnë ose jo KVR-të në këto tre bashki, por dhe se si ato perceptohen prej vetë anëtarëve të tyre.

Pyetëtori përbëhej nga dy pjesë. Në të parën, anëtarët e KVR-ve ftoheshin të ndanin të dhëna për të bërë profilizimin demografik të tyre, për të mundësuar qartësi në analizimin e përgjigjeve. Në pjesën e dytë anëtarëve u drejtoheshin 9 pyetje kyç për të bërë të mundur krijimin e panoramës së funksionimit të KVR-ve.

Parë nga ana demografike, pyetëtori u plotësua në një shtrirje moshore prej 17 vjeç në 36 vjeç, gjë që rrit besueshmërinë e përgjigjeve duke qenë se çdo çështje shihet nga këndvështrimet e personave në fasha të ndryshme moshore. Ndarja gjinore po ashtu ishte thuajse e barabartë për femra dhe meshkuj (7 femra dhe 6 meshkuj), fakti që gjithashtu rrit besueshmërinë e përgjigjeve, si dhe shmang animin e tyre në një kah dhe rrezikun për anashkalimin e problemeve me bazë gjinore.

Sa i përket pjesës së dytë, anëtarëve të KVR-ve iu drejtuan pyetje në lidhje me ngirtjen ose jo të KVR-së sipas kuadrit ligjor, numrin e anëtarëve të KVR-së përkatëse, mënyrën e trajtimit të vakancave në KVR, buxhetimin dhe financimin e KVR-së, suportin shtesë të bashkisë, trajnimet dhe ëorkshop-et e organizuara nga bashkia, nëse ata vetë si anëtarë ndiheshin ose jo të kënaqur, impaktin dhe rolin që KVR-ja e tyre luan te të rinjtë e asaj bashkie, si dhe nëse ishin të mendimit se duheshin bërë ndryshime në ligj dhe të çfarë natyre duhet të ishin këto ndryshime.

Duke i parë në mënyrë të përgjithshme, nga 13 përgjigje që mori ky pyetësor, 12 ishin të mendimit se në ngirtjen e KVR-ve ishin zbatuar plotësisht normat ligjore në fuqi. Mbi vakancat, po ashtu 12 veta nga 13 pohuan se ato janë krijuar gjatë funksionimit të KVR dhe se janë plotësuar sipas parashikimeve ligjore mbi plotësimin e vakancave. Vetëm një përgjigje (nga 4 në total për atë bashki) nga Bashkia Has mohon ndjekjen e procedurave të rregullta ligjore për plotësimin e vakancës.

Sa i takon pyetjes mbi numrin e anëtarëve, është interesante të vihet në dukje që në bashkitë Has dhe Kukës përgjigjet janë të ndryshme, herë duke shtuar dhe herë duke hequr një nga numri i dhënë nga përgjigjet e tjera. Përgjigjet nga Bashkia e Tropojës, përkundrazi janë gjithnjë '6 anëtarë'. Që këtu (dhe si do të evidentohet më poshtë), vihet re funksionimi më i mirë i KVR-së së Bashkisë

Tropojë, e cila duket se kryen më tepër mbledhje se dhe dy bashkitë e tjera e për rrjedhojë dhe anëtarët e KVR-ve njohin njëri-tjetrin dhe janë të aftë të evidentojnë se sa janë në total. Kjo problematikë përkon dhe me përgjigjet që kanë dhënë anëtarët e KVR-ve ndaj pyetjeve që lidhen me organizimin e aktiviteteve, mbledhjeve, ëorkshop-eve apo trajnimeve nga Bashkia për KVR-të, pasi anëtarët e KVR Tropojës duken në masë më të kënaqurit kur pyeten për funksionimin e KVR-së së tyre në këtë pikë.

Së fundmi, nga të gjithë përgjigjet 6 veta janë pro ndryshimit të ligjit dhe duket se shtrirë në rang bashkisë ata janë mazhorancë, pavarësisht se jo numerike, pasi bëhet fjalë për të 4-të anëtarët e KVR-së Kukës dhe gjysmën e KVR-së Has që është pro ndryshimeve. Bie në sy që KVR Tropoja, ku të gjithë anëtarët (5 përgjigje) janë të kënaqur me funksionimin e KVR-së për shkak të financimit të mirë (sipas perceptimit të tyre) që bën bashkia⁸, si dhe aktiviteteve, nuk shohin nevojën për të bërë ndryshime në ligj. Kjo gjë është shumë interesante, sepse në dy bashkitë e tjera (Hasi dhe Tropoja), dhe nëse ishin të kënaqur me funksionimin e KVR-së, gjithsesi ishin pro ndryshimeve në ligj për të parashikuar me patjetër një fond të dedikuar KVR-së në buxhetin vjetor të bashkisë. Duket se për mirëfunksionimin e KVR-ve është kyç financimi i sigurt i tyre, gjë që evidentohet te suksesi i Bashkisë Tropojë dhe te problemet e Bashkive Has dhe Kukës.

Duke i parë përgjigjet e anëtarëve të KVR-ve sipas çdo bashkie, vihen re të mëposhtmet:

Bashkia HAS

Norma e kthimit të përgjigjeve ka qenë e lartë me 4 përgjigje nga 5 anëtarë në total që përbëjnë KVR-në. Anëtarët kanë qenë vetë të paqartë për numrin e tyre. Vihet re dhe një ndarje shumë e theksuar e qëndrimeve që ata kanë mbajtur në përgjigjet e tyre. Përbërja demografike ka qenë 1 femër dhe 3 meshkuj.

⁸ Ndonëse anëtarët e KVR Tropojë shprehen se financimi vjen nga fondet e buxhetit vjetor të bashkisë, eksperti i angazhuar për verifikimin e të dhënave të mbledhura nga pyetësorët, ka konstatuar se nuk është ky burimi i fondeve që kanë mbuluar aktivitetet e KVR Tropojës.

Gjysma (2 veta) është shprehur se financimi i KVR-së ka qenë i mirë, pasi bashkia ka krijuar mundësitë me anë të projektit 'Perspektiva të reja', mbështetur nga Sëisscontact, dhe se në kuadër të këtij projekti bashkia ka ofruar suport shtesë, workshop-e dhe trajnime. Kjo gjysmë shprehet e kënaqur nga funksionimi i KVR-së dhe nuk mendojnë se duhet të ketë ndërhyrje në ligj.

Nga ana tjetër, gjysma tjetër shprehet jo vetëm se nuk ka patur as financim dhe as suport shtesë nga bashkia, por edhe që nuk janë njoftuar për mbledhje, aktivitete apo trajnime. Natyrisht, kjo gjysmë shprehet e pakënaqur për mosfunksionimin e KVR-së dhe është e mendimit se ligji duhet ndryshuar, duke dhënë dhe rekomandime konkrete mbi nevojën për patjen e një buxheti stabël për KVR-në nga buxheti vjetor i bashkisë, nevojën për të shpërblyer vetë anëtarët e KVR-së me një shumë monetare (qoftë dhe modeste), nevojën për të mos patur për kryetar vetë kryetarin e bashkisë, por një kryetar të zgjedhur nga ta, si dhe nevojën për të patur rol më të rëndësishëm në vendimmarrjen e bashkisë për politika rinore nëpërmjet konsultimit të tyre në lidhje me to.

Në fakt, sa i takon rolit dhe impaktit të KVR-së te rinia e Bashkisë Has, 3 veta shprehen se KVR ka një rol të rëndësishëm duke qenë të vetëdijshëm në të njëjtën kohë që pavarësisht rolit që duhet të luajë, KVR nuk ka patur impakt për shkak të mënyrës se si ka operuar.

Bashkia TROPOJË

Si u vu në dukje dhe më sipër, bashkia Tropojë ka patur rezultatin më të kënaqshëm, sipas vetë anëtarëve të KVR-së Tropojë. Norma e përgjigjeve dhe këtu ishte shumë e lartë me 5 përgjigje nga 6 anëtarë në total në KVR Tropojë. Vlen të theksohet se mirëfunksionimi i saj duket që te fakti që anëtarët janë të aftë të gjithë që të evidentojnë numrin total të anëtarëve. Përbërja demografike e përgjigjeve për këtë KVR ka qenë 3 femra dhe 2 meshkuj.

Në lidhje me financimin, të gjithë anëtarët u shprehën se KVR financohet me zë të veçantë në buxhetin e Bashkisë Tropojë⁹. Po ashtu, në lidhje me suportin shtesë të bashkisë, trajnimet apo ëorkshop-et, anëtarët pohuan të gjithë se bashkia i ofronte këto lehtësira për ta.

Si dhe u tha më sipër, është e vetmja bashki ku unanimisht askush nuk është i mendimit se duhen bërë ndryshime në ligj për të përmirësuar situatën ku ndodhet KVR-ja e tyre respektive.

Bashkia KUKËS

Për sa i përket Bashkisë Kukës, po ashtu norma e kthimit të përgjigjes për pyetëtorin ishte shumë e lartë. 4 anëtarë nga 5 gjithsej në KVR Kukës iu përgjigjën pyetëtorit. Përbërja e tyre demografike ishte 3 femra dhe 1 mashkull.

Është interesant fakti se të treja KVR-të e qarkut Kukës, ndodhen në pozita të ndryshme sa i përket kënaqshmërisë së funksionimit të tyre të anëtarët. Nga ekstremi i të kënaqurve ndodhet KVR e Tropojës. Në mesin perfekt ndodhet KVR e Hasit dhe në ekstremin e të pakënaqurve duket se ndodhet KVR e Kukësit, pasi vetëm një person në 4 është i kënaqur nga funksionimi i deritanishëm i KVR.

Për Kukësin është interesant të vihet në dukje fakti se dhe personi i kënaqur me mënyrën se si ka vepruar KVR der më tani, pranonte se mungonte financimi nga Bashkia Kukës i KVR Kukës dhe se nuk kishte trajnime, workshop-e apo suport shtesë nga bashkia dhe pse shprehte besimin se të tilla forma mbështetjeje do të zhvilloheshin në të ardhmen me anë të bashkëpunimeve mes Bashkisë dhe OJQ-ve me të cilat bashkia kishte lidhur ose do të lidhte bashkëpunim.

Për më tepër të gjithë binin dakort mbi nevojën për të ndryshuar ligjin mbi dy pika/rekomandime kryesore:

⁹ Si është cituar dhe më parë në raport (shih shën.8), kjo nuk është mënyra se nga janë financuar aktivitetet, dhe pse anëtarët nuk e kanë bërë dot këtë dallim pasi financimi gjithsesi është mundësuar nga Bashkia, por jo në formën e përfshirjes në buxhetin vjetor.

1. Nevojën për të zgjedhur vetë të rinjtë kryetarin e KVR-së dhe që ky post të mos përkojë me postin e kryetarit të bashkisë
2. Nevojën për financimin e KVR-së nga një zë në buxhetin vjetor të Bashkisë, prej ku të paguheshin, qoftë dhe simbolikisht vetë anëtarët e KVR-së, si mënyrë inkurajimi për angazhimin e tyre.

V. Kujt i drejtohet ky studim?

Nga natyra e kauzës, ky studim i drejtohet dy autoriteteve më të larta nën varësinë e të cilëve janë institucionet që ngarkohen për të zbatuar ligjin ‘Për Rininë’, përkatësisht, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Kryetarët e Bashkive, Kukës, Has dhe Tropojë.

VI. Korniza Ligjore e Këshillave Vendor Rinor

Për të arritur pjesëmarrjen efektive të të rinjve është e nevojshme që një numër i caktuar instrumentesh ligjore të funksionojnë. Këto instrumenta duhet të krijojnë kushtet për dialog dhe partneritet të mirëfilltë ndërmjet të rinjve në nivel vendor nëpërmjet mundësisht të përfshirjes së të rinjve si aktorë kryesorë në politikat që i prekin. Në këtë kuadër, pjesëmarrja efektive e të rinjve në nivel lokal duhet të bazohet në vetëdijen e tyre për ndryshimet sociale që ndodhin brenda komunitetit të tyre dhe kërkon një strukturë përfaqësuese të përhershme e cila të manifestojë dhe ndryshimet që grupimet e të rinjve kërkojnë si rrjedhojë e një politike të caktuar që prek po ata.

Në shumicën e vendeve të cilat përmbajnë një akt të tillë¹⁰ ku në to përfshihet dhe Shqipëria, “Ligji Për Rininë” është instrumenti ligjor kryesor që rregullon çështjet e rinisë me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të të rinjve, strukturën dhe funksionimin e organizatave rinore, si dhe mënyrat për pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse lokale.

¹⁰ Psh. Ne Serbi, Ligji për Rininë është dokumenti zyrtar detyrues që u drejtohet të rinjve/të rinjve, aktorëve të politikave rinore, aktiviteteve rinore, punës rinore me qëllim mbështetjen e të rinjve në organizata, aktivizmin social, zhvillimin dhe përmbushjen e potencialit të tyre për veten e tyre. dhe për të mirën e shoqërisë. Ndersa ne Finlande, për Rininë mbulon politikat rinore, punën për të rinjtë dhe përgjegjësitë përkatëse të qeverisjes qendrore dhe vendore, bashkëpunimin ndërsektorial si dhe financimin shtetëror. Ligji për Rininë ne Finlande plotësohet me Dekretin e Qeverisë për Punën dhe Politikën Rinore.

Në Shqipëri, qëllimi i ligjit “Për Rininë”¹¹ është përcaktimi i veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë, si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti.¹² Sipas këtij ligji, krijimi i Këshillave Vendorë Rinor është përgjegjësi e njësisë të vetëqeverisjes vendore. Këto të fundit, mund të aplikojnë për t’u mbështetur nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për rininë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi. Ato gjithashtu bashkëpunojnë me organizatat për të rinjtë dhe organizatat rinore shqiptare në diasporë, për të mbajtur komunikimin me të rinjtë shqiptarë që janë larguar nga vendi për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimin në aktivitetet që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli Vendor Rinor sipas këtij ligji, është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Ky organ ka rol këshillues për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë ku në të njëjtën kohë vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor. Gjithashtu, Këshilli Vendor i Rinisë propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë dhe në të njëjtën kohë bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë i cili në vetvete është organ këshillimor, që funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë.¹³ Këshilli Vendor Rinor kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Vendor Rinor emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.¹⁴ Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit vendor të rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar, për aq sa është e mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.¹⁵ Këto elementë përsa i përket Këshillit Kombëtar të Rinisë janë të përcaktuara në Vendimin Nr. 969, Datë 2.12.2020 të Këshillit të Ministrave.¹⁶ Si rrjedhojë, në

¹¹ Ligji Nr. 75/2019 “Për Rininë”

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2019/11/04/75/bed73fae-2777-483f-a130-25277479c5d2>

¹² Neni 2 i Ligjit “Per Rinine”

¹³ Neni 10, pika 1 i Ligjit “Per Rinine”

¹⁴ Neni 10, pika 2 i Ligjit “Per Rinine”

¹⁵ Neni 10, pika 3 i Ligjit “Per Rinine”

¹⁶ Vendimi Nr.969/2020 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të menyrës së organizimit e të funksionimit të tij”

përputhje me këtë vendim, mund të themi se anëtari i KVR-së mund të japë dorëheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim kryetarin. Anëtari i dorëhequr është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet e lëna deri në miratimin e urdhrit të ndryshimit. Ai gjithashtu, duhet të deklarojë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe të kryejë detyrën e tij bazuar në parimin e mosdiskriminimit, të meritës, transparencës e gjithëpërfshirjes. Mandati i anëtarëve të KVR-së është dyvjeçar, me të drejtë riemërimi.

VII. Funksionimi i Këshillave Vendorë të Rinisë në Qarkun e Kukësit

Përsa i përket funksionimit të Këshillave Vendor Rinor në Qarkun e Kukësit, situata paraqitet jo e njëtrajtshme në të tre bashkitë përbërëse. Pavarësisht numrave të përafërt të anëtarëve të KVR-ve në të treja bashkitë, vihet re se ndër të treja bashkitë, ajo më e sukseshmja në menaxhimin e KVR-së, sipas vlerësimit të vetë anëtarëve, është Bashkia e Tropojës. KVR-ja e Bashkisë Tropojë ka gëzuar mbështetjen dhe suportin e bashkisë dhe në formën e trajnimeve apo ëorkshopeve për anëtarët e KVR-së. Sa i takon Bashkisë së Hasit, ajo e ka siguruar financimin dhe suportin e KVR-së jo prej buxhetit të saj vjetor, por me anë të sigurimit të një Projekti ('Perspektiva të Reja'), me mbështetjen e Sëisscontact. Bashkia e Hasit, po ashtu, ka arritur të organizojë trajnime për anëtarët e KVR-së.

Tjetër paraqitet situata në Bashkinë Kukës, ku bashkia nuk ka suportuar as me financim dhe as me trajnime apo workshop-e, anëtarët e KVR-së, të cilët e kanë patur të vështirë organizimin e aktiviteteve si rrjedhojë e këtij fakti, e si rezultat nuk kanë mundur të përmbushin si duhet funksionin për të cilin konstituohet KVR-ja.

VIII. Përfundime dhe Rekomandime

Me anë të të dhënave që ky studim mblodhi nga anëtarët e KVR-ve në tre bashki: Has, Tropojë, Kukës mund të evidentohen disa përfundime, të shtjelluara më poshtë.

1. Ekziston një raport i drejtë mes financimit stabil të KVR-ve dhe kënaqshmërisë së punës së tyre për vetë anëtarët e tyre. Duke mundësuar financimin e KVR-ve, bashkitë rrjedhimisht ndihmojnë anëtarët e tyre në përmbushjen e detyrave të tyre duke mundësuar organizimin e aktiviteteve me impakt të rinia lokale. Në vijimësi të ekzistencës së KVR-ve, me anë të mirëfinancimit të tyre mund tju jepet mundësia të rinjve të bashkive respektive që të jenë pjesë e fushatave sensibilizuese të organizuara nga KVR-të, por dhe të jenë në kontakt më të afërt me përfaqësuesit e tyre rinorë.
2. Anëtarët e KVR-ve ndiejnë dhe vërejnë se patja për kryetar të këshillit të tyre, kryetarin e bashkisë, pengon mbarëvajtjen e KVR-së, për shkak dhe të ngarkesës që ka kryetari i bashkisë nga detyrat e tjera ku ai merr pjesë. Për më tepër, anëtarët e KVR-ve nuk evidentojnë ndonjë përfitim nga ky kontakt i drejtpërdrejtë me kryetarin e bashkisë për sa kohë vetë KVR-ja nuk ka luajtur rol konsultativ mbi vendimet e bashkisë në lidhje me politikat rinore.
3. Mungesa e mbledhjeve të shpeshta sjell si rrjedhojë paqartësinë e vetë anëtarëve të KVR-ve në lidhje me numrin e 'kolegëve' të tyre, gjë që në vetvete pengon mundësinë e këtyre të fundit për t'u mirëorganizuar dhe për të patur impakt të rinjtë vendor. Për më tepër, kjo mungesë mbledhjesh duket se ndikon dhe te përballja e anëtarëve të të njëjtës KVR me dy realitete të kundërta, si në rastin e KVR Has.
4. Evidentohet fort dhe nevoja për të inkurajuar anëtarët e KVR-së për të qendruar në strukturë. Numri i shumtë i vakancave të krijuara përgjatë ekzistencës së shkurtër të KVR-së, si dhe pasiviteti i treguar prej tyre (parë prapë nga këndvështrimi i tyre), pengojnë shumë mbarëvajtjen e KVR-së.
5. Vihet re nevoja e krijimit të urave të komunikimit me anëtarët e KVR-ve, pasi raportimi i ndryshëm i të njëjtit set faktesh ngre pikëpyetje mbi njohjen e tyre me njëri-tjetrin dhe me punën e KVR-së.

Në vijim të përfundimeve të mësipërme, veçojmë si të vlefshme këto rekomandime që vijojnë më poshtë:

1. Marrjen e masave nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për realizimin e amendimeve ligjore në ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë” me synimin për të ndarë funksionin e Kryetarit të KVR-së nga funksioni i Kryetarit të Bashkisë.
2. Marrjen e masave nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për realizimin e ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, me synimin për të përcaktuar qartësisht në ligj se financimi i KVR-ve do të bëhet në formën e një zëri të përvitshëm në buxhetin vjetor të Bashkisë, krahas përcaktimit ligjor të mënyrave për përfitimin e fondeve shtesë nga bashkëpunimet me projekte që kanë në fokus rininë.
3. Marrjen e masave nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për realizimin e ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, për të përcaktuar një shumë shpërblimi monetar (idealisht një shumë jo më të vogël se gjysma e pagës minimale) për anëtarin e KVR-së dhe lehtësi të tjera për kryerjen e detyrës së tyre, si p.sh. ulje në përdorimin e naftës apo transportit publik si dhe çdo lehtësi që ul kostot vetjake të angazhimit të tyre.
4. Marrjen e masave nga të gjitha Bashkitë e Republikës së Shqipërisë për të pajisjur me një mjet identifikimi (tip kartë) anëtarët e KVR-ve për të mundësuar lehtësitë e sipërpërmendura.
5. Marrjen e masave nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për të përcaktuar në ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, kompetencat e KVR si organ konsultativ dhe përforcimin e pozitës së KVR në procesin vendimmarrës lokal në lidhje me politikat rinore.

6. Marrjen e masave nga Ministria përgjegjëse për Rininë (Ministria për Rininë dhe Fëmijët) për konsultimin me një sërë organizatash rinore para çdo iniciativë për ndërhyrje në ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”.
7. Marrjen e masave nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme ligjore në ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë” për të parashikuar mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin periodik të performancës së KVR-ve.
8. Marrjen e masave nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për realizimin e ndryshimeve ligjore për përcaktimin në ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, të mundësisë së KVR-së për të mbështetur projekte dhe iniciativa lokale në lidhje me përmirësimin e jetës së rinisë lokale.

ANEXS

Pyetësi për funksionimin e KVR-e në Kukës, Has dhe Tropojë

Mosfunksionimi i KVR-ve pengon përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje, duke ndikuar për rrjedhojë në qeverisjen e mirë ose mungesën e saj. Ky pyetësor vjen në funksion të monitorimit, vlerësimit dhe hartimit të një raporti mbi funksionimin apo mos-funksionimin e KVR-ve në tre bashki: Kukës, Has, Tropojë. Synimi i tij është orientimi dhe informimi rreth gjendjes aktuale të KVR-ve në këto tre bashki.

Ky pyetësor po zbatohet në kuadër të Projektit “No to Corruption, Yes to democracy” zbatuar nga Qendra për Progres Rinor Kukës, mbështetur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Një raport përmbledhës i monitorimit me gjetjet dhe rekomantimet do të dërgohet tek Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Kryetarëve të Bashkive, Kukës, Has dhe Tropojë.

Raporti nuk do të ekspozojë të dhënat tuaja personale.

1. Seksioni i të dhënave personale

- a. Emër/Mbiemër _____
- b. Moshë _____
- c. Email:

2. Seksioni rreth funksionimit aktual të KVR-ve në Has, Kukës dhe Tropojë:

2.1 A është ngritur KVR në Has/Kukes/Tropoje në mbështetje të plotë dhe sipas legjislacionit aktual (Ligji 75/2019 ‘Për rininë’ dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, pra vendimet e Këshillit Bashkiak mbi kriteret e ngritjes së tij)?

- a. Po
- b. Jo

2.2 Sa anëtarë ka, konform ligjit dhe KVB, KVR e Hasit/Kukesit/Tropojës

Has _____ Kukes _____ Tropoje _____

2.3 Nga momenti i krijimit të KVR deri në momentin aktual, a janë krijuar vakanca në KVR e Hasit/Kukesit/Tropojës?

- a. Po ___Has/Kukes/Tropoje
- b. Jo

2.4 Në momentin e krijimit të vakancave në KVR e Hasit/Kukesit/Tropojës, a janë plotësuar vakancat në mënyrë të rregullt, konform me ligjin dhe VKB?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk janë krijuar vakanca

2.5 Neni 7, pika 1, paragrafet ‘dh’ dhe ‘ë’, e ligjit ‘Për Rininë’, parashikon detyrimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore (Bashkisë) për të financuar krijimin dhe zhvillimin e infrastrukturës rinore si dhe për të parashikuar në buxhetet e tyre fonde për të realizuar të drejtat e të rinjve. Si reflektohet kjo dispozitë të financimi/buxhetimi për KVR e Bashkisë Has/Kukes/Tropoje?

2.6 A ofron Bashkia Has/Kukes/Tropoje ndihmesë dhe suport shtesë për anëtarët e KVR në formën e trajnimeve apo ëorkshopeve për t’i ndihmuar këta të fundit ta kryejnë sa më denjësisht detyrën e tyre?

2.7 Sa të kënaqur jeni me politikat rinore të bashkisë Has/Kukes/Tropoje në shkallën nga 1(aspak i kënaqur) deri në 5(shumë i kënaqur)? Pse?

- a. 1)Aspak i kënaqur
 - b. 2)Disi i kënaqur
 - c. 3)Neutral
 - d. 4)I kënaqur
 - e. 5)Shumë i kënaqur
-
-

2.8 Çfarë roli dhe çfarë impakti ka KVR në jetën e të rinjve në bashkinë Has/Kukes/Tropoje?

2.9 A mendoni se duhet të ndryshojë ligji për funksionimin më mirë të KVR-ve

- a. Po (jepni shpjegime/rekomandime)
-
-

- b. Jo

